



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1802 / Prot.
11

Tiranë, më 14.07 2023

V E N D I M

Nr. 77 datë 14.07 2023

" P Ë R
REDUKTIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR CIKLIN E TRETË TË
STUDIMEVE DOKTORATË NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"

Bazuar në Ligjin nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH" pika 3/ç të nenit 3, të nenit 6 pika 28,29,30 të nenit 38, të nenit 77,78,79, në Statutin e UST, në Rregulloren e UST-së, në shkresën nr.90/2 datë 12.01.2023 "Kërkohej miratimi i kuotave për Ciklin e Tretë të studimeve në UST për vitin akademik 2022-2023", në shkresë nr. 90/3, datë 18.01.2023 "Informacion mbi përcaktimin e udhëheqësve për programet e ciklit të tretë Doktoratë në UST për kuotat e vitit akademik 2022-2023", në vendimin e Senatit Akademik nr. 27, datë 16.02.2023 "Për miratimin e rregullores për organizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në UST", në shkresën e MAS nr. 2747 datë 27.04.2023 "Mbi kuotat e pranimit për vitin akademik 2023-2024", në vendimin e Senatit nr. 46 date 07. 04.2023 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, për vitin akademik 2023-2024 në UST", në Vendimin e BA nr. 32 datë 02. 05.2023 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, për vitin akademik 2023-2024 në UST" në shkresën e MAS nr. 203/2, datë 30 .06.2023 "Mbi listën e udhëheqësve shkencorë në programet e studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë për vitin 2022-2023 ", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 14 .07.2023,

V E N D O S I:

1. Tarifat e aplikimit për aplikantët (FSHL,FVFR) dhe tarifat e regjistrimit të fituesve (FSHL,FVFR) për ciklin e tretë të studimit Doktoratë , në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2022-2023, të jetë sipas Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 22 datë 26-04-2022;
2. Të miratojë tarifën e shkollimit për studentët që do të ndjekin studimet në ciklin e tretë të studimit doktoratë për të dy fakultetet sipas tabelës bashkëngjitur;
3. Tarifa e shkollimit për ciklin e tretë do të paguhet me këste;

4. Tarifa vjetore e shkollimit për ciklin e tretë Doktoratë të bëhet publike në faqen zyrtare të Universitetit www.ust.edu.al;
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, FSHL, FVFR, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtoria e Marrëdhënive me Jashtë, Publikun dhe Studentëve.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr.Agron KASA



FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

Tab. 1

Emertimi I Programit cikli I trete te studimeve Doktorate	Tarifa e shkollimit (per kandidatet nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit per te tjere, ne leke
Shkenca Sportive (FSSL)	400 000	800 000

Tab. 2

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

Emertimi I Programit cikli I trete te studimeve Doktorate	Tarifa e shkollimit (per kandidatet nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit per te tjere, ne leke
Aktivitet Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	400 000	800 000